

Q.F. 100000
Gjendur: Bashkëlit
20.07.22

3353
dt. 19.07.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 826/ prot.

Elbasan, më 15.7.2022

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK LIBRAZHD

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.58 datë 30.06.2022 “Për pjesëmarrjen e Bashkisë Librazhd në Subjekte me Kompetenca të Përbashkëta, me qëllim kryerjen e shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura“, konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Majlinda PERRIU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Dt.04.07.2022

Nr. 3147/prot
14

Nr.58 dt.30.06.2022

**PËR PJESMARRJEN E BASHKISË LIBRAZHD NE SUBJEKTE ME KOMPETENCA
TË PËRBASHKËTA ME QELLIM KRYERJEN E SHËRBIMEVE TË FURNIZIMIT ME
UJË TË PIJSHËM, GRUMBULLIMIT, LARGIMIT DHE TRAJTIMIT TË UJËRAVE
TË NDOTURA**

Në mbështetje të nenit 113, të Kushtetutës, të Nenit 9, dhe të pikës 1 dhe 5, të Nenit 14 e vijues të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar, të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, VKM nr 302 dt 11.05.2022 per : "Politikat kombetare per riorganizimin e sektorit te furnizimit me uje dhe te largimit, trajtimit dhe perpunimit te ujrave te ndotura", te ndryshuar ,Keshilli Bashkiak i mbledhur sot me date 30.06.2022 dhe me propozim te Kryetarit te Bashkise Librazhd.

VENDOSI:

1. Autorizimin e Kryetarit te Bashkisë, në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", për të negociuar me shoqëritë publike të Ujësjetllës Kanalizimeve qe aktualisht ushtrojnë shërbime te furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura në Republikën e Shqipërisë si dhe Ministrisë se Infrastrukturës dhe Energjisë, për mundësinë lidhjen e marrëveshjes specifike për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta, për kryerjen e veprimtarisë së mësipërme në zonat e shërbimit.
2. Autorizimin e Kryetarit te Bashkisë ne cilësinë e tij si Aksionar i Shoqerise Aksionere "Ujësjetllësi Kanalizime Librazhd", qe pas krijimit të Subjekteve me Kompetenca të Përbashkëta ku Bashkia do te jete aksionare, te vijoje me miratimin ne Asamblenë e Përgjithshme te Aksionareve te autorizimit për Administratorin e Shoqërisë Aksionare "Ujësjetllësi Kanalizime Librazhd", për nënshkrimin e çdo akti te nevojshëm kontraktore dhe noterial me qellim transferimit te veprimtarisë ekonomike për tek shoqëria e re SKP-UK qe do te krijohet.
3. Ndjek zbatimin e këtij vendimi Kryetari i Bashkise Librazhd.
4. Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes.

Sek.i Keshillit
Elson Malluta

KRYETARI I KËSHILLIT
Shefki Bahiti

